



K.DH.SH.II.nr.1033/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Faton Bajrami, kryetar i kolegjit, Saranda Bogaj Sheremeti dhe Ramush Bardiqi, anëtar të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “A...G...” Sh.P.K me seli në Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson B.E., avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Dogana e Kosovës (DK), në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.490/18, të datës 17.12.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 30.03.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

Aprovohet si e bazuar ankesa e të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative Divizioni Fiskal, A.nr.490/18 i datës 17.12.2020, **Prishet** dhe lënda i kthehet gjykatës së shkallës së parë, në rigjykim dhe rivendosje.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.490/18 të datës 17.12.2018 është aprovuar kërkesëpadia e paditësit “A...G...” Sh.P.K me seli në Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson B.E., avokat nga Prishtina, si e bazuar, ashtu që është anuluar aktvendimi i të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, nr.07.3/791/2015 i datës 14.02.2018, dhe është obliguar e paditura Dogana e Kosovës në Prishtinë që paditësit “A...G...” Sh.P.K me seli në Prishtinë, t’ia kthej detyrimet e paguara më tepër në emër të taksave doganore importuese, në vlerë prej 1,976.42€, të cilat detyrime janë paguar sipas Deklaratës Unike Doganore R-26966/11.07.2015 të ZBD Prishtinë.

Kundër këtij aktgjykimi e paditura Dogana e Kosovës, ka ushtruar ankesë për shkak të: zbatimit të gabuar të drejtës materiale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljes së dispozitave të procedurës LKA-së. Me propozim që të aprovohet ankesa si e bazuar me ligj, prishet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë A.nr.490/18, të datës 17.12.2020 si i pabazuar në ligj dhe lë në fuqi vendimin e kontestuar.

I autorizuari i paditësit, avokati B.E. në përgjigje në ankesë e konteston në tërësi ankesën, me propozim që e njëjta të refuzohet si e pa bazuar dhe të vërtetohet Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti Administrativ A.nr.490/18 datë 17.12.2020.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore, përgjigjen në ankesë dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të

nenit 49 të LKA, nenit 81.H të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222, lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), gjeti se:

- Ankesa është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me aktvendimin e kundërshtuar, nr.07.3/791/2015 i datës 14.02.2018 të Doganës së Kosovës në Prishtinë, është refuzuar kërkesa e subjektit në procedurë "A...G..." Sh.P.K me seli në Prishtinë, për rishqyrtimin e vendimit nr.R-26966/11.07.2015 të lëshuar nga ZBD Prishtinë, si e pa bazë.

Paditësi i pakënaqur me vendimin e Doganës së Kosovës, ka ushtruar padi për konflikt administrativ, me pretendim se i njëjti është i pa drejtë dhe i paligjshëm. Gjykata e shkallës së parë, pas shqyrtimit të padisë së paditësit paraqitur kundër vendimit, nr.07.3/791/2015 i datës 17.02.2018, të Doganës së Kosovës në Prishtinë, në seancën e shqyrtimit kryesor e duke u bazuar edhe në provat dhe dëshmitë e tjera të lëndës, bie aktgjykimin e ankimuar me të cilin padinë e paditësit e aprovon si të bazuar, ashtu që është anuluar aktvendimi i të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, nr.07.3/791/2015 i datës 14.02.2018, dhe është obliguar e paditura Dogana e Kosovës në Prishtinë që paditësit "A...G..." Sh.P.K me seli në Prishtinë, t'ia kthej detyrimet e paguara më tepër në emër të taksave doganore importuese, në vlerë prej 1,976.42€, të cilat detyrime janë paguar sipas Deklaratës Unike Doganore R-26966/11.07.2015 të ZBD Prishtinë.

Gjykata e shkallës së parë, pasi vlerësoi aktvendimin e kundërshtuar dhe pas administrimit të provave si dhe dokumentacioni që gjendet në shkresat e lëndës, vendosi që ta aprovojë kërkesëpadinë e paditësit. Me arsyetim se paditësi ka dëshmuar para të paditurës dhe gjykatës, faturën përcjellëse të mallit nr. KA150505 datë 08.06.2015, packing list, urdhërpagesat ndërkombëtare datës 06.05.2015 dhe 17.06.2015 të P... Bank të cilat pagesa janë bërë pikërisht për numrin e faturës përcjellëse KA150505 me të cilën është deklaruar dhe zhdoganuar malli lëndor, kontratën e shitblerjes që ka të njëjtën vlerë të mallit doganor, faturën e transportit të cilat dokumentacione janë në tërësi të harmonizuara në kuptim të vlerës së mallit në përputhje me dispozitat e nenit 123 të UA 11/2009 për implementimin e KDAK, andaj është konstatuar se janë përmbushur kriteret ligjore për tu pranuar vlera e deklaruar sipas faturës së mallit të deklaruar me DUD R-26966/11.07.2015 të ZBD Prishtinë, dhe malli lëndor të vlerësohet sipas nenit 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës 03/L-109 respektivisht sipas vlerës së transaksionit që paraqet çmimin e vërtetë të paguar për mallrat e shitura eksport në Kosovë.

Dhoma e Shkallës së Dytë, duke u nisur nga një gjendje e tillë e çështjes dhe duke i shqyrtuar vendimet e organit të paditur, aktgjykimin e ankimuar të gjykatës së shkallës së parë, si dhe shkresat e tjera të lëndës, gjen se aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 183 paragrafi 1, vërtetimin e gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike dhe zbatim i gabuar i të drejtës materiale nga neni 184 i LPK-së.

Kolegji i kësaj gjykate vlerëson se në procedurë gjyqësore të konfliktit administrativ shqyrtohet dhe vlerësohet ligjshmëria e një akti administrativ përfundimtar si në këtë rast, sipas dispozitave ligjore të LKA-së, LPK-së dhe ligjeve materiale. Në rastin konkret, gjykata e shkallës së parë ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit pa e vërtetuar në tërësi gjendjen faktike të dokumentacionit përcjellës që e ka shoqëruar DUD-in R-26966/11.07.2015 ZBD Prishtinë. Kolegji vlerëson se Gjykata e shkallës së parë në këtë rast ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit mbi bazën e provave të administruara në seancën gjyqësore të dt.17.12.2020 duke u

bazuar në nenin 33 të KDAK-së përkatësisht nenin 123 të UA 11/2009, mirëpo në bazë të analizimit të dokumentacionit si dhe nga pretendimi i të paditurës në ankesë se e paditura assesi nuk mund të pajtohet për faktin se paditësi nuk ka arritur me prova të besueshme e mbi të gjitha me transaksion bankar të vërtetohet pretendimet e tij se vlera e mallit kontesutes është reale, ku shihet se në këtë transaksion bankar i prezantuar ka mospërputhje për faktin se si eksportues i mallit për Kosovë sipas deklaratës dhe faturës përcjellëse të mallit paraqitet D...L...Sh..., nga Kina, ndërsa në transaksione bankare si përfitues paraqitet një subjekt krejt tjetër me emrin Y...O...I...E...L..., dhe mbi bazën e këtyre fakteve konform dispozitave të Kodit Doganor e Akcizave e paditura ka përcaktuar vlerën e emalit për qëllime doganore konform nenit 35 të KDAK-së. Kolegji i kësaj Gjykate konstaton se transferet e datës 06.05.2015 dhe 17.06.2015 në P... Bank të cilat gjendet në shkresat e lëndës nuk përmbajnë emrin e eksportuesit të mallit lëndor ashtu siç parashihet në paragrafin 3 të nenit 33 të KDA-se : *“Çmimi i vërtet i paguar apo i pagueshëm është pagesa e plotë e bërë nga blerësi për shitësin në dobi të këtij të fundit për mallin e importuar dhe që përfshin të gjitha pagesat e bëra ose që duhet bërë, si kusht i shitjes së mallrave të importuara nga blerësi për shitësin, ose nga blerësi për një palë të tretë për ta përmbush obligimin ndaj shitësit. Pagesa mund të mos bëhet patjetër në formën e transferit të parave. Pagesa mund të bëhet me anë të letrave të kredis apo ndonjë mjeti tjetër të dakorduar të pagesës dhe munde të bëhet drejt për drejtë ose në mënyrë të tërthortë”*. Bazuar në këtë dispozitë ligjore, kolegji i kësaj gjykate konstaton se nga transferet bankare të datës 06.05.2015 dhe 17.06.2015 të P... Bank dhe nga fatura përcjellëse e mallit nr. KA150505 datë 08.06.2015, pagesa është bërë për Y...O...I...E...L..., ndërsa eksportues i mallit është D...L...Sh... Po ashtu në kontratën e shitblerjes nuk ka ndonjë marrëveshje mes eksportuesit dhe importuesit që pagesa e mallit të bëhet përmes ndërmjetësuesit.

Në ri procedurë Gjykata e shkallës së parë, duhet t'i shqyrtojë të gjitha vërejtjet e dhëna nga kolegji i kësaj gjykate, t'i eliminoj të gjitha shkeljet e theksuara më lartë, të vendos në kuptim të nenit 160 të LPK-së, ashtu që t'i administroj në tërësi provat e lëndës, duke ballafaquar dokumentacionin përcjellës të mallit lëndor të zhdoganuar me DUD-in R-26966/11.07.2015 në ZBD Prishtinë, të ofruara nga palët ndërgjyëse, dhe të nxjerr konstatimin se a janë plotësuar kushtet ligjore për t'ia pranuar paditësit, vlerën e transaksionit konform nenit 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave, ashtu që dokumentacioni i mallit lëndor të jetë i harmonizuar në kuptim të vlerës me faturë. Varësisht nga gjendja faktike e provave të administruara, gjykata e shkallës së parë të nxjerr vendim të drejtë dhe të bazuar në ligj.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Dytë
K.DH.SH.II.nr.1033/22, me datë 30.03.2023

Kryetar i kolegjit
Faton Bajrami